



Dt. 12.03 2025 Në përputhje me statutin e Komunës së Pejës, ligjin për qeverisje lokale me numër 03L/040, dhe rregulloren e Komunës së Pejës me nr.02/2016 për “Tituj të Nderit, Dekorata, Medalje, Mirënjohje dhe Falenderime”, respektivisht me nenin 6, pika 6 e kësaj rregulloreje, DKRS lëshon këtë:

THIRRJE PUBLIKE

për propozime të kandidatëve për “Tituj Nderi”

Ftohen të gjitha institucionet Publike dhe Private, Organizatat Joqeveritare, Grupet Joformale qytetare (me seli dhe adresë) dhe mediat që të kontribuojnë në zgjedhjen e personave meritor për titujt të nderit si:

- **1.Titulli “Qytetar Nderi”**
- **2.Titulli “Qytetar Nderi i Huaj”**
- **3.Titulli “Qytetar Nderi Post Mortum”**
- **4.Titulli “Nderi i Qytetit”**
- **5.Titulli “Lekë Dukagjini”**
- **6.Titulli “Haxhi Zeka”**
- **7.Titulli “Azem Shkreli”**

Gjithashtu, ftoheni që ti sillni propozimet edhe për persona (kandidatë) të cilëve do t’iu ndahen dekoratat si:

- **1. Mirënjohje, Falenderime-** për kontributin e tyre ndër vite si dhe
- **2. Laureat për të drejtat e grave dhe vajzave-** për kontributin e dhënë në mirëqenien dhe profilin e grave dhe vajzave meritorë.

PROPOZIMET DUHET TË PËRMBAJNË:

- **1.Biografinë** e kandidatit të propozuar
- **2.Arsyetimin** – të sqarohet cili ka qenë kontributi i kandidatit që ai/ajo të meriton titullin e propozuar (2000 fjalë)
- **3.Fakte** të cilat vërtetojnë arsyetimin (fotografi, shkrime, publikime)
- **4.Listën e nënshkrimeve (minimalisht 200)** të personave që e kanë dhënë propozimin (lista të përmbaj: emrin .mbiemrin, ditëlindjen, vendlindjen, numrin personal, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e secilit propozues)

SI TË APLIKONI:

Të përpiqet shkresa Zyrtare/ PROPOZIMI të cilit duhet t’i bashkangjitet letërnjoftimi i personit përfaqësues / Aplikuesit.

Lënda duhet të dorëzohet e mbështjellur në bustë (zarfë) të mbyllur në sportelin e administratës

Afati i dorëzimit të propozimeve është me datë: 12.03.2025 deri më 14.04.2025

Lënda duhet t’i drejtohet: Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport

Për t’u informuar rreth përkufizimeve të titujve, ju lutem hyni në faqen elektronike të Komunës së Pejës, në rubrikën Rregulloret dhe shkarkoni rregulloren për Dekorata.

Ky është linku:

<https://kk-arkiva.rks-gov.net/peje/getattachment/35a59117-5a89-4e59-8df4-250d2c47bd5c/Rregullore-Nr-02-2016-per-tituj-tenderit-dekoratav.aspx>